



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 17 shkronja r) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 37 paragrafi 1.18, nenin 38. paragrafi 1.4 dhe nenin 46 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01.nr.16-126211 të datës 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e të mbajtur më 26.05.2015, miratoi këtë:

REKOMANDIM

1. **I Rekomandohet** Kryetarit të Komunës që në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të Teatrit, Njësia për Kulturë dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të angazhohen për një zgjidhje të përkohshme dhe ta foemojnë një nënkod të veçantë buxhetor për Teatrin e Qytetit të Gjiçanit dhe të angazhohen që Teatri të funksionoj si Institucion i pavarur i kulturës, duke ofruar shërbime cilësore kulturore me mundësinë e komercializimit të disa hapësirave me qëllim të krijimit të të hyrave vetanake
2. Po ashtu i **Rekomandohet** Kryetarit të Komunës që të punohet në rikthimin e statusit të Teatrit, në Teatër Profesional, duke përfshirë edhe financimin nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe krahas kësaj të punohet në ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Teatrit.
3. Deri në gjetjen e zgjidhjes rreth definimit të statusit të Teatrit në bashkëfinancim me MKRS, Komuna të bëjë subvencionimin e projekteve teatrore në mënyrë që Ansambli i aktorëve të përformojë konform projekteve. Po ashtu Rekomandohet që Tetari të vazhdojë reprizimin e shfaqjeve nga reportuari i tij me qëllim të rritjes së përformacës, shikueshmërisë dhe krijimit të të hyrave vetanake.
4. Zbatimin e këtij Rekomandimi e benë Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Njësia për Kulturë, Rini e Sport.

01.Nr. 016-49454
Gjiçan, më 26.05.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi